

## KONTRATE SHIT-BLERJE TE PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE

### CLOVER SHPK

Sot me date 18/11/2020 ( dy mije e njetzet) palet perpiluan kete kontrate shitje kuotash si me poshte vijon;

#### **PALA SHITese :**

Z. Ardit Osmeni i datelindjes 02/07/1989 lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane me ID I90702024C

#### **PALA BLERese :**

Znj. Elisabeta Gjebrea, e datelindjes 20/02/1978 lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane me ID H85220064V me zotesi te plote juridike per te vepruar

**OBJEKTI :** Transferimi me ane te shitjes i 50% te pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise "CLOVER" SH.P.K; kapital ne vleren 50.000 leke (pesedhjete mije leke) nga shitesi Ardit Osmeni tek bleresi Elisabeta Gjebrea

Me date 12/10/2018 eshte rregjistruar shoqeria CLOVER shpk me seli ne KASHAR Rruga Dytesore Tirane Durres, km 6, godina nr.1 (QTU), dyqani nr.21, Kati I-re me objekt aktiviteti: Tregti me shumice dhe pakice e artikujve te veshjes, kozmetike. Veprimtari ne fushen e "IMPORT EXPORT" dhe tregtim i artikujve te veshjes, aksesoreve te tyre, produkteve tekstile perfshire ato per arredimin e shtepise, veshje intime, kemishtari etj. Shitje, blerje dhe marrje me qera titujsh dhe materialesh, dhe ne pergjithesi, çdo veprim qofte me natyre juridike dhe financiare, industriale, publike ose tregtare, prona te tundshme ose te patundshme te gjitha keto, te cilat lidhen me objektin e shoqerise ose me te tjera te cilat jane te ngjashme ose te peraferta dhe ndihmojne direkt ose indirekt objektin e shoqerise ne shtrirjen dhe zhvillim e saj. Per te realizuar aktivitetin dhe arritjen e qellimit te saj, shoqeria mund te kryeje aktivitete te tjera. Çdo lloj veprimi tregtar, industrial e financiar, mobiluar e jo mobiluar, duke perfshire ndertimin, shitjen dhe menaxhimin e ndertesave qe kane lidhje me qellimin e shoqerise. Si objekt te veprimtarise se saj shoqeria do te kete edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik te lejuar nga legjislacioni shqiptar qe perputhet me objektin e veprimtarise se saj dhe qe ka kane rendesi per te ardhmen e shoqerise., rregjistruar ne QKB me Nipt L82212021T me status aktiv dhe kapital themeltar 100,000 ( njeqind mije ) leke, i ndare si me poshte:

1. Elisabeta Gjebrea me 50% te kapitalit themeltar me vlere 50,000 (pesedhjete mije leke)
2. Ardit Osmeni me 50% te kapitalit themeltar me vlere 50,000 (pesedhjete mije leke)



U vendos:

1. Miratimi per transferimin e 50% te pjeseve te kapitalit themeltar qe zoterohen nga ortaku **Ardit Osmeni** tek ortaku **Elisabeta Gjebrea**
2. Transferimi i pjeseve te kapitalit behet me kontrate shitblerje dhe konsiderohet i perfunduar me permbushjen e plote te detyrimeve kontraktuale te paleve dhe depozitimin e kontrates se shitblerjes se ketyre pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise ne QKB:

Kushtet e kontrates:

1. Shitesi **Ardit Osmeni** eshte ortak i Shoqerise "CLOVER" shpk zoterues i 50% te pjeseve te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie, te cilat tia shese ortakut **Elisabeta Gjebrea**, ne vleren e tyre nominale, vlere e cila eshte shlyer plotesisht.
2. **Elisabeta Gjebrea** ka vendosur te bleje 50% te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise "CLOVER" shpk qe zoteronte ortakut **Ardit Osmeni**
3. Shitesi i siguron bleresit se pjeset e kapitalit themeltar, objekt i kesaj kontrate jane te lira nga cdo pretendim apo e drejte e personave te trete ne castin e kalimit te pronesis se tyre tek bleresi, por pergjigjet edhe nese keto te meta shfaqen me pas.
4. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, depozitimin e saj dhe te akteve qe lidhen me kete transferim te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise ne QKB; shitesi **Ardit Osmeni** zhvishet nga cdo e drejte pronesie mbi 50% te pjeseve kapitalit themeltar te shoqerise "CLOVER" shpk, objekt i kesaj kontrate dhe zoterues i tyre behet bleresi **Elisabeta Gjebrea**, duke u bere zoteruese e 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise.
5. Kjo kontrate hyn ne fuqi menjehere me nenshkrimin e saj nga palet, te cilat nuk mund te ndryshojne kushtet e vendosura ne te me pelqimin e tyre.
6. Kjo kontrate eshte hartuar ne gjuhen shqipe, ne perputhje te plote me vullnetin e lire te paleve ne dy kopje te barazvlefshme.
7. Kontrata pasi u lexua me ze te larte, palet nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire sipas ligjit

**PALA BLERESE**

Elisabeta Gjebrea  




**PALA SHITESE**

Ardit Osmeni  
